



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:064628
Datë: 18.12.2018
Numri i dokumentit: 00191025

P. nr. 1372/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM-me gjyqtaren individuale Fitore Daci dhe procesmbajtësin – praktikantin e kësaj gjykate Besmir Rrahmani, në lëndën penale kundër të pandehurit N.M për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me nenin par. 1 te KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm PP/II. nr 1844-10/2018 të datës 24.10.2018, pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar më 17 dhjetor 2018 në prani të Prokurorit të Shtetit Ismet Rrahmani, të pandehurit N.M shpall dhe publikisht komunikon këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **N.M**, nga i ati... dhe e ëma ... gjinisë..., i lindur me, me vendbanim në fsh. ..., K Shtime, punëtor, i martuar, baba i gjashte fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike, i punësuar, shqiptar , shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. letërnjoftimit.....

Ë s h t ë f a j t o r

Se me dt. 29.08.2018, rreth orës 14:20, në rr. “Komandant Kumanova”, Shtime, duke drejtuar automjetin e markës “VW Golf”, ngjyre e zeze, me targa te regjistrimit..., ne kundërshtim me nenin 41.1 te Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Rrugor nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik jetën e njerëzve dhe pasurinë, duke mos qene i sigurt ka ndërmerr veprim jo te sigurt te ku rrezikon veten dhe pjesëmarrësit e tjerë ne komunikacion, në atë mënyrë qe me te arritur te rr.”Komandant Kumanova” nuk e ka respektuar shenjat e trafikut shenjen “STOP” për tu ndaluar dhe me pjesën e perparme te anës se djathte e godet ne pjesën e majte pjesën e pasme automjetin e markës “Opel Zafira” me ngjyrë hiri e me targë te regjistrimit..., te cilën e drejtonte S.K, nga inercioni i goditjes njësia dy me pjesën e pare te policisë me targe te regjistrimit..., me ç’rast nga kjo goditje përveç dëmeve materiale ne automjetet lëndime trupore pëson drejtuesi i njësisë tre zyrtari policor-i dëmtuari Z.B te përshkruara si ne ekspertizën mjeko ligjore te dt. 25.09.2018.

-me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me nenin par. 1 te KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 23, 41, 43, 46, 73, e 374 par 1 të KPRK-së si dhe te nenit 365 të KPPK-së,

E g j y k o n

Me dënim me gjobe në shumë prej 200€ (dyqind euro).

I dëmtuari Z.B per realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest juridiko civil.

Dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë. Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohen në mënyrat tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-se, dënimi do të ekzekutohet në atë mënyrë që i pandehuri për çdo 20 Euro do të vuaj një ditë burgimi.

Obligohet i pandehuri që Gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të ia paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro), shpenzimet e procedurës penale ne shume prej 60.88 € (gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent) si dhe ne emër të fondit të kompensimit te viktimave të krimit shumen prej 30€ (tridhjetë euro) në afat prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP/II. nr 1844-10/2018 të datës 24.10.2018 ndaj të pandehurit N.M për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me nenin par. 1 te KPRK-së.

Duke vepruar sipas kësaj akuze, në këtë Gjykatë me 17 dhjetor 2018 është mbajtur shqyrtimi fillestar sipas dispozitave të nenit 245 te KPPK-së.

Pranimi i fajësisë nga i pandehuri

I pandehuri N.M në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me nenin par. 1 te KPRK-së, e cila i vihet ne barrë me aktakuzën e prokurorit te shtetit.

Ka deklaruar se është pënduar për kryerjen e kësaj vepre dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepër të natyrës së tillë apo vepër tjetër penale.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjyqtarja individuale në shqyrtimin fillestar konstatoi se i pandehuri e ka pranuar fajësinë pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare, si dhe pranimi i fajit është mbështetur në të gjitha faktet dhe provat e paraqitura nga prokurori në aktakuzë dhe me këtë janë përmbushur te gjitha kushtet ligjore te parapara në nenin 248 te KPPK-së, dhe në këtë mënyrë shqyrtimin fillestar e ka përfunduar pa administruar provat e tjera dhe ka vazhduar me shqiptimin e dënimit siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 248 të KPPK-së.

Vlerësimi ligjor i veprimeve të pandehurit

Gjyqtarja individuale po ashtu konstatoi se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me nenin par. 1 të KPRK-së, për të cilën veprë i pandehuri është penalisht përgjegjës dhe është ndëshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Vlerësimi i dënimit për të pandehurin

Me rastin e matjes së dënimit për të pandehurin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 i KPRK-se, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata ka marr për bazë pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pendimin e tij për kryerjen e kësaj vepre penale, ndërsa si rrethanë renduese gjykata pati parasysh faktin se vepra e tillë penale është e përhapur mjaft dhe paraqet një rrezikshmëri të caktuar shoqërore.

Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, duke i shërbyer preventivës speciale-që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej veprë penale dhe duke ndikuar te personat e tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale-preventiva gjenerale.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle dhe ato të procedurës penale, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6, lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P.nr.1372/2018, më datë 17.12.2018.

Procesmbajtësi

Besmir Rrahmani

Gjyqtarja Individuale

Fitore Daci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund te ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit, në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në drejtim të sanksionit penal.